

MARRËVESHJA E LICENSIMIT TË PËRDORUESIT TË FUNDIT TË KLIENTIT BLACKBERRY

Ky softueri i klientit ("**Klienti**") ofrohet nga BlackBerry Limited ose filiali ose dega e tij ("**BLACKBERRY**"), dhe ofrohet vetëm për përdorim në lidhje me programin që ka lidhje me enterprise serverin dhe shërbimin ("**Softuer Serveri**"), të cilat së bashku me Klientin dhe Aplikimet Menaxhuese të përcaktuara më poshtë (të gjitha së bashku "**Softueri i klientit**") referohen këtu si "**Zgjidhja**".

Për të instaluar, aktivizuar ose përdorur një Softuer Klienti, ju duhet që (a): të keni (i) lidhur me BLACKBERRY një Marrëveshje Licensimi të Zgjidhjes BlackBerry për Zgjidhjen, përfshirë çdo shtojcë ose kusht shtesë që lidhet me Zgjidhjen, ("**Licensa BBSLA**") për llogarinë tuaj; dhe (ii) nëse kërkohet për Zgjidhjen tuaj, të keni marrë, dhe paguar tarifat, nëse ka, për një Licensë Aksesi Klienti për instalimin, aktivizimin dhe përdorimin e Softuerit të Klientit të tillë në pajisjen tuaj; ose (b) të jeni autorizuar të instaloni, aktivizoni dhe përdorni Softuerin e Klientit në interes të punëdhënësit tuaj ose të një entiteti tjetër ligjor ("**Entiteti Ligjor**") i cili: (i) ka lidhur një Licensë BBSLA, (ii) ju ka vënë në dijeni për kushtet e përdorimit të Softuerit të Klientit nga ana juaj sipas Licensës BBSLA, (iii) ka pranuar të mbajë përgjegjësi për përdorimin nga ana juaj të Softuerit të Klientit; dhe (iv) nëse kërkohet për Zgjidhjen tuaj të Entitetit të Licensuar, të ketë marrë dhe paguar tarifat, nëse ka, për Licensë Aksesi Klienti për instalimin, aktivizimin dhe përdorimin e Softuerit të Klientit të tillë në pajisjen tuaj.

Organizata juaj mund të përdorë Zgjidhjen për të kryer menaxhimin e aplikacioneve për celularë ("**MAC**") duke ju vënë në dispozicion aplikacione që janë krijuar për të punuar ose në anën personale ose në hapësirën e punë së pajisjes tuaj ("**Aplikacionet e menaxhuara**") që përfshijnë aplikime softueri të ofruara nga një palë e tretë. Aplikime të cilat quhen Softuer i Palëve të Treta sipas Licensës BBSLA. Softueri i Palëve të Treta mund të përfshijë kushte dhe afate shtesë midis jush ose Entitetit tuaj të Licensuar dhe furnizuesit të Softuerit të Palës së Tretë që rregullon përdorimin e saj. BLACKBERRY nuk mban përgjegjësi për Softuerin e Palës së Tretë, si dhe të gjitha pyetjet ose problemet që lidhen me të duhet të adresohen tek furnizuesi i Softuerit të Palës së Tretë.

Organizata juaj mund të përdorë Zgjidhjen për të kryer funksione të menaxhimit të pajisjes celulare ("**MPC**") në pajisje, duke përfshirë mbledhjen e informacioneve personale. Organizata juaj është përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin, përdorimin dhe menaxhimin e të gjitha informacioneve të mbledhura me anë të Zgjidhjes.

Përveç kushteve të mësipërme, nëse ju keni marrë ndonjë Softuer të Klientit nga Njësia Apple e Aplikimeve iTunes, ju njihni dhe pranoni për llogari të Entitetit të Licensuar, për llogari të të cilit ju autorizoheni të instaloni, aktivizoni dhe përdorni Softuerin e Klientit, ose nëse nuk autorizoheni kështu, ju njihni dhe pranoni për llogarin tuaj, që (i) Apple nuk ka asnjë lloj përgjegjësie për Softuerin e Klientit të tillë, duke përfshirë pa kufizim funksionimin, mirëmbajtjen dhe mbështetjen e tij, ose për çdo pretendim nga ndonjë palë e tretë që ky Softuer Klienti cenon të drejtat e pronësisë intelektuale të një pale të tretë. Në rast se Softueri i Klientit nuk pajtohet me ndonjë garanci të aplikueshme, ju mund të njoftoni Apple, dhe Apple do t'ju rimbursojë çmimin e blerjes për këtë Softuer të Klientit, nëse ka të tillë, dhe në masën maksimale

të lejueshme nga ligji në fuqi, Apple nuk do të ketë asnjë detyrim tjetër garantimi në lidhje me Softuerin e Klientit., dhe (ii) Apple dhe filialet e saj janë palë të treta përfituese të kësaj Marrëveshje dhe kanë të drejtë (dhe do të konsiderohet se e kanë pranuar këtë të drejtë) të zbatojnë këtë Marrëveshje si një palë e tretë përfituese.

DUKE KLIKUAR NË BUTONIN "UNË PRANOJ" MË POSHTË, OSE DUKE INSTALUAR, AKTIVIZUAR APO PËRDORUR NDONJË NGA SOFTUERËT E KLIENTIT, JU: (I) PRANONI SE KENI LEXUAR, KUPTUAR DHE PRANONI TË VEPRONI NË PËRPUTHJE ME DHE TË RESPEKTONI KËTË MARRËVESHJE DHE E SIGURONI BLACKBERRY SE KUSHTET NË a) OSE b) MË SIPËR JANË PËRMBUSHUR. **NËSE JU NUK PRANONI KËTË MARRËVESHJE OSE NUK PËRMBUSHNI NDONJË NGA KUSHTET MË SIPËR , JU NUK MUND TËINSTALONI, AKTIVIZONI APO PËRDORNI SOFTUERIN E KLIENTIT.**